KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin e bordit të ERE-s nr. 273, datë 27.10.2022 "Mbi rishikimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a., dhe FTL sh.a., për periudhën kohore 1.1.2022 deri më 31.12.2022", botuar në Fletoren Zyrtare nr.152, datë 15.11.2022, bëhen korrigjimet, si më poshtë:

I. Baza ligjore e vendimit

Ishte:

.....Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27. 10.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/3 prot., datë 21.10.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike, "Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a., për periudhën kohore 01/01/2022 deri më 31/12/2022" ,

Bëhet:

..... Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27. 10.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/3 prot., datë 21.10.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike "Mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a., për periudhën kohore 01/01/2022 deri më 31/12/2022"

II. Pika 2 e dispozitivit të vendimit

Ishte:

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë të shoqëritë KESH sh.a., dhe FSHU sh.a., për vendimin e bordit të ERE.

Bëhet:

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë të shoqëritë KESH sh.a., dhe FTL sh.a., për vendimin e bordit të ERE.